



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SLLAVO-BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë C (Turqisht)

Ngarkesa: 8 kredite; 60 orë mësimore; - leksione / 60 seminare

Semestri kur zhvillohet: Viti I / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Lënda e gjuhës praktike në gjuhën turke është një lëndë e detyrueshme, me 8 kredite, që zhvillohet 6 orë në javë dhe shlyhet në fund të semestrit në formën e provimit firmë. Është një lëndë praktike që mundëson mësimin e gjuhës turke në një nivel të caktuar nëpërmjet një metode të njohur sipas Kuadrit European të Gjuhëve. Lënda është e organizuar në seminare dhe shërben si lëndë praktike për të zhvilluar kompetencat gjuhësore të studentëve në gjuhën turke dhe për të arritur një nivel të caktuar gjuhësor. Studentët njihen me struktura të ndryshme gramatikore të gjuhës turke, punojnë me fjalorin, mësojnë fjalë dhe shprehje të reja, ushtrohen nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme dhe zhvillojnë aftësinë e të lexuarit, të shkruarit, të folurit dhe të dëgjimit, arrijnë një nivel të caktuar gjuhësor nëpërmjet metodës së përzgjedhur.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- Të njihet me struktura të reja gramatikore që shpjegohen në metodën e përzgjedhur.
- Të arrijë nivelin gjuhësor të përcaktuar nga metoda e përzgjedhur.
- Të punojë individualisht dhe në grup për të ushtruar rregullat gjuhësore të mësuara në metodën e përzgjedhur.

Objektivat specifike lëndore:

- Të mësojë rregullat gjuhësore të shpjeguara në metodën e përzgjedhur.
- Të lidhë informacionin gjuhësor të nivelit të mëparshëm gjuhësor me informacionin e ri që mëson në vazhdimësi të metodës.
- Të dallojë strukturat e reja gramatikore.
- Të lexojë dhe të kuptojë tekstet e dhëna në metodë.
- Të shkruajë saktë në gjuhën turke.
- T'u përgjigjet saktë pyetjeve të pjesëve të dëgjimit të realizuara nga folës të gjuhës turke që kanë lidhje me temat e metodës.
- Të pasurojë leksikun e tij për të komunikuar në turqisht.